



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Thirrje publike

Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) 2026

Masa 2: Mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro dhe të vogla

Nën Masa 2.3: Mbështetje për biznese ekzistuese

**UDHËZUES PËR APLIKIM,
VLERËSIM DHE
ZBATIM TË PROJEKTEVE PËRFITUESE**

Data e hapjes së thirrjes: 18.05.2026

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: 18.06.2026

Tabela e përmbajtjes

HYRJE	4
Qëllimi i Udhëzuesit	4
I. APLIKIMI.....	5
OBJEKTIVAT E APLIKIMIT	6
Kush mund të aplikojë?.....	6
Sektorët e përjashtuar nga financimi.....	7
Kriteret e kualifikimit dhe kërkesat specifike.....	8
Kriteret e përgjithshme të pranueshmërisë	8
Përjashtimet nga aplikimi	8
SI TË APLIKONI?.....	9
Procesi i aplikimit.....	9
Udhëzime për plotësimin e aplikacionit	9
Propozimi i buxhetit.....	10
KOSTO E PRANUESHME DHE TË PAPRANUESHME PËR FINANCIM	10
Kostot e pranueshme	10
Kostot e papranueshme.....	10
Parandalimi i mashtrimit dhe penalizimet	11
VLERAT E PLANIFIKUARA TË MBËSHTETJES FINANCIARE	11
DOKUMENTET E KËRKUARA PËR APLIKIM.....	12
Lista e dokumenteve që duhet të dorëzohen.....	12
NDIHMË DHE MBËSHTETJE	13
Kontakte për pyetje dhe ndihmë.....	13
AFAFTET E APLIKIMIT.....	13
Data e hapjes dhe mbylljes së aplikimit	13
Korrigjimi i lëshimeve teknike gjatë fazës së aplikimit.....	13
II. VLERËSIMI.....	14
PROCESI I VLERËSIMIT DHE SELEKTIMIT	15
Metoda e vlerësimit.....	15
Faza I - vlerësimi administrativ	15
Faza II - vlerësimi përmbajtjesor	15
Faza III - verifikimi në teren	16
Faza e ankesave	16
Kriteret e vlerësimit.....	17
INFORMACIONE MBI MËNYRËN E NJOFTIMIT TË APLIKANTËVE TË PËRZGJEDHUR.....	17
Lista rezervë	17
III. ZBATIMI I PROJEKTIT	18
ZBATIMI DHE MONITORIMI I PROJEKTIT	19

Shkurtesat

MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
DPKZHR	Departamenti për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal
DBF	Divizioni për Buxhet dhe Financa
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës
CRK	Regjistrin e Kredisë së Kosovës

HYRJE

Qëllimi i Udhëzuesit

Ky udhëzues është hartuar me synimin për të ofruar një orientim të qartë, gjithëpërfshirës dhe praktik për të gjitha palët e interesuara që synojnë të përfitojnë nga mbështetja financiare dhe teknike e **Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) 2026**.

Duke qenë se zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm dhe përkrahja e ndërmarrjeve vendore përbëjnë një nga shtyllat kyçe të këtij programi, udhëzuesi shërben si një mjet orientues për të interesuarit, përfaqësuesit institucional dhe të gjithë aktorët e përfshirë në ciklin e jetës së projekteve.

Përmes këtij dokumenti synohet të sigurohet një proces i drejtë, transparent dhe i strukturuar për identifikimin, vlerësimin, përzgjedhjen dhe mbështetjen e projekteve që kanë potencial të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik rajonal, rritjen e konkurrueshmërisë së bizneseve dhe përfshirjen sociale të komuniteteve. Ky udhëzues është hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar, Rregulloren (QRK) Nr. 21/2024 për Menaxhimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar, Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2025–2027, si dhe aktet përkatëse të miratuara nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) për këtë thirrje.

Udhëzuesi përshkruan në detaje të gjitha fazat e procesit, duke filluar nga publikimi i thirrjes për aplikim, kriteret dhe procedurat për aplikim, vlerësimi dhe përzgjedhja e projekteve, nënshkrimi i kontratave, zbatimi i projekteve, monitorimi, raportimi dhe vlerësimi përfundimtar.

Gjithashtu, dokumenti qartëson rolet dhe përgjegjësitë e palëve nënshkruese përgjatë gjithë ciklit të projektit, si dhe ofron udhëzime praktike për palët duke siguruar zbatim të suksesshëm të projekteve.

Nëpërmjet këtij udhëzuesi, synohet të lehtësohet bashkëpunimi ndërmjet sektorit privat dhe institucioneve publike, të nxitet kultura e ndërmarrësisë, si dhe të përforcohen mekanizmat e llogaridhënies dhe transparencës në shpërndarjen e fondeve publike.

I. APLIKIMI

OBJEKTIVAT E APLIKIMIT

Objektivë e përgjithshme e kësaj thirrjeje është të mbështesë zhvillimin e ndërmarrjeve mikro dhe të vogla, përmes granteve që kontribuojnë në **përmirësimin e kapaciteteve prodhuese dhe shërbyese dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik rajonal**.

Objektivat specifike të kësaj thirrjeje janë:

1. **Përmirësimi i kapaciteteve të biznesit:** Të mundësohet përmirësimi i strukturës dhe kapaciteteve operacionale të bizneseve ekzistuese për të rritur efikasitetin dhe konkurrencën e tyre në treg.
2. **Zhvillim rajonal i qëndrueshëm:** Të mbështeten projekte që mundë të sjellin përfitime ekonomike në rajon dhe ndikim pozitiv në jetën e komunitetit.
3. **Përmirësimi i cilësisë së produkteve dhe shërbimeve:** Me makinerinë/aparaturën e Projekt propozimit synohet përmirësimi i cilësisë dhe ofrimi i produkteve apo shërbimeve të reja që u përshtaten nevojave të tregut.
4. **Aplikimi i teknologjive të reja:** Synohet të promovohen teknologji moderne dhe praktikrat efikase që rrisin produktivitetin dhe menaxhimin e qëndrueshëm.
5. **Zgjerimi në tregje të reja:** Synohet të mbështeten bizneset që duan të eksportojnë dhe të lidhen me tregje të reja, duke rritur kapacitetin eksportues dhe zvogëlimin e importeve.

Përmes këtyre objektivave, aplikuesit potencial mund të adresojnë nevojat dhe mundësitë që ofrohen nga programi dhe të krijojnë projekte që kanë ndikim të drejtpërdrejtë dhe të qëndrueshëm në zhvillimin e biznesit dhe rritjen e ekonomisë rajonale.

Kush mund të aplikojë?

Në kuadër të **Masës 2** të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2026, ofrohet përkrahje për ndërmarrjet mikro dhe të vogla që synojnë të zhvillojnë kapacitetet e tyre prodhuese dhe shërbyese. Ky program mbështet përmirësimin e infrastrukturës teknike dhe teknologjike, rritjen e konkurrencës, si dhe forcimin e aftësisë së ndërmarrjeve për të përballuar sfidat e tregut të brendshëm dhe ndërkombëtar. Gjithashtu, kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm dhe rritjen ekonomike të rajoneve.

Aplikantët mund të përfitojnë mbështetje financiare për të arritur këto qëllime, duke mundësuar zhvillimin dhe rritjen e bizneseve të tyre në përputhje me standardet e tregut.

Grupi i synuar për këtë thirrje përfshin:

- **LOT 1** – Biznese ekzistuese veprimtari prodhuese dhe shërbyese me qarkullim vjetor për vitin paraprak (2025) nga 10,000 euro deri në 300,000 euro;

Rajonet zhvillimore dhe Komunat

Klasifikimi territorial shërben si bazë për shpalljen e thirrjes publike për aplikim, për përzgjedhjen e projekteve me ndikim rajonal dhe për shpërndarjen proporcionale të fondeve bazuar në Ligjin për Zhvillim Rajonal të balancuar me Nr.08/L-190, në Rregulloren (QRK) për Menaxhimin e Programit për Zhvillim Rajonal të balancuar me NR.21/2024, në Programin për Zhvillim rajonal të balancuar 2025-2027, dhe në Udhëzuesit e miratuar të MZHR-së për këtë thirrje. Për më tepër, në vlerësimin e projekteve do të merret parasysh kontributi i tyre në zvogëlimin e pabarazive ndër-rajonale dhe në nxitjen e potencialeve zhvillimore të secilës komunë dhe rajon.

Rajoni Zhvillimor	Komunat
(01) Qendër	Prishtinë, Podujevë, Obiliq, Fushë Kosovë, Lipjan, Glogoc, Graçanicë
(02) Veri	Mitrovica e Jugut, Skenderaj, Vushtrri, Zveqan, Leposaviq, Zubin Potok, Mitrovica Veriore
(03) Perëndim	Pejë, Istog, Klinë, Deçan
(04) Jug	Prizren, Suharekë, Dragash, Mamushë
(05) Juglindje	Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Shtërpcë, Hani i Elezit
(06) Lindje	Gjilan, Kamenicë, Viti, Novobërda, Partesh, Ranillukë, Klllokot
(07) Jugperëndim	Gjakovë, Rahovec, Malishevë, Junik

Sektorët e përjashtuar nga financimi

Në kuadër të kësaj thirrjeje, **nuk kualifikohen për mbështetje financiare** aplikimet që i përkasin sektorëve të mëposhtëm:

- **Tregtia** (me pakicë dhe shumicë);
- **Ndërtimtaria**, me përjashtim të pajisjeve dhe makinerive për prodhimin e materialeve ndërtimore. **Nuk kualifikohen:** ndërtimi i objekteve, blerja e mjeteve lëvizëse apo aktivitete të ngjashme, si dhe shërbimet e ndërlidhura me ndërtimtarinë;

- **Bujqësia**, përfshirë çdo pajisje apo aktivitet që lidhet me veprimtari bujqësore, **përfshirë bërjen e makinerisë për prodhimin dhe përpunimin e produkteve, të cilat nuk financohen nga MBPZHR:**
- **Shëndetësia** – përfshirë ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe aktivitetet që ndërlidhen me to;
- **Arsimi** – përfshirë institucionet arsimore dhe ofrimin e shërbimeve në fushën e edukimit.

Përfshirja e këtyre sektorëve bazohet në ndarjen institucionale të përgjegjësisë dhe faktin se ato mbulohen nga programe të tjera shtetërore për mbështetje ekonomike.

Kriteret e kualifikimit dhe kërkesat specifike

Kriteret e përgjithshme të pranueshmërisë

Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare, aplikantët duhet të plotësojnë këto kriteret:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jenë ndërmarrje me pronësi 100% private, të regjistruara në Kosovë sipas ligjeve në fuqi;
- Të jenë të regjistruar për aktivitetet që parashihen në projekt-propozim, në kohën e aplikimit; *(në konsideratë merren vetëm aplikimet që veprimtaria primare ose ajo sekondare në Certifikatë të biznesit të përkojë me projekt propozimin me të cilin aplikohet në këtë thirrje);*
- Të jenë në gjendje të demonstrojnë likuiditetin aktual apo potencial të ndërmarrjes;
- Të dëshmojnë përmbushjen e detyrimeve tatimore dhe kontributeve përmes certifikatave nga ATK;
- Të jenë drejtpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit të propozuar, pa vepruar në emër të ndonjë pale të tretë.

Përmbushja e plotë e kriterëve të pranueshmërisë është kusht themelor për vlerësimin dhe përzgjedhjen e aplikimit.

Përfshirjet nga aplikimi

Aplikantët potencialë që **nuk mund të përfitojnë mbështetje financiare** nga kjo thirrje janë ata që ndodhen në ndonjë nga situatat e mëposhtme:

- **Kanë shpallur falimentim**, janë në proces të mbylljes, janë nën administrim gjyqësor, kanë pezulluar aktivitetin afarist, janë përfshirë në marrëveshje me kreditorë, ose janë subjekt i procedurave të tjera të ngjashme ligjore;
- **Janë të klasifikuar në kategorinë D, E, W në Regjistrin e Kredisë së Kosovës (CRK)** për llogaritë personale ose të biznesit;
- **Nuk janë në përputhje me obligimet e tyre sa i përket pagesës së tatimeve dhe kontributeve** sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës;
- **Aplikanti ose personat që kanë autorizim përfaqësimi**, vendimmarrjeje apo kontrolli mbi aplikantin **janë dënuar për ndonjë veprë** që lidhet me sjelljen profesionale me një aktgjykim të formës së prerë nga një autoritet kompetent;
- **Aplikanti, aksionarët apo përfaqësuesit e biznesit janë subjekt i një aktgjykimi të formës së prerë për mashtrim, korrupsion, përfshirje në organizatë kriminale, pastrim parash apo ndonjë aktivitet tjetër të paligjshëm**, i cili cenon interesat financiare të Republikës së Kosovës;
- **Bizneset (pronarët, aksionarët apo të autorizuarit e tyre) që kanë përfituar nga thirrjet e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar gjatë viteve 2024 dhe 2025**, si dhe përfituesit e PZHRB 2022, 2023, 2024 dhe 2025 që nuk kanë realizuar me sukses projektet e tyre nuk kualifikohen për të përfituar nga kjo thirrje.

SI TË APLIKONI?

Procesi i aplikimit

Aplikimi realizohet **online** përmes platformës zyrtare **e-Kosova**.

Aplikantët duhet të zgjedhin linkun përkatës:

- [LOT 1](#)

Udhëzime për plotësimin e aplikacionit

- Plotësimi i aplikacionit bëhet online përmes platformës e-Kosova.
- **Çdo fushë e formularit duhet të plotësohet në mënyrë të plotë dhe të saktë.** (Sistemi nuk lejon kalimin në pyetjen pasuese pa përfunduar fushën paraprake).
- **Është thelbësore që informatat e dhëna të jenë të sakta, të qarta dhe në përputhje me qëllimin dhe përmbajtjen e projektit që propozohet.**
- **Çdo përpjekje për të përdorur inteligjencën artificiale në plotësimin e pyetjeve do të rezultojë në penalizim.**

- Projekti duhet të përshkruhet në mënyrë origjinale (**jo copy-paste**).

Propozimi i buxhetit

- **Buxheti** duhet të jetë **i plotësuar në tërësi** dhe të reflektojë **ndarjen e detajuar të fondeve për makinerinë/apaturën e projektit**.
- Sigurohuni që të gjithë zërat e shpenzimeve të jenë të përfshirë dhe të harmonizuar me objektivat dhe kriteret e thirrjes publike.
- Buxheti duhet të jetë **realist dhe i justifikueshëm**, në përputhje me kërkesat për mbështetje financiare.
- Buxheti dhe oferta duhet të kenë përputhshmëri në masën 100%.

KOSTO E PRANUESHME DHE TË PAPRANUESHME PËR FINANCIM

Aparatura/Makineria e projekt propozimit duhet të kenë ndikim konkret dhe të matshëm në:

- Zgjerimin e kapaciteteve prodhuese/shërbyese,
- Përmirësimin e ciklit të zhvillimit të produkteve/shërbimeve,
- Diversifikimin e produkteve apo tregjeve,
- Zhvillimin e zinxhirit të vlerës në tregun vendor dhe ndërkombëtar.

Kostot e pranueshme

Vetëm shpenzimet për aparaturë, makineri, softuer do të konsiderohen për financim.

Të tilla janë:

- Blerja e pajisjeve, makinerive, linjave të prodhimit, softuerëve, etj.;

Kostot e papranueshme

Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të pranueshme për financim:

- **Shpenzimet e marketingut,**
- **Shpenzimet e trajnimeve,**
- **Borxhet dhe tarifrat** për mbulimin e borxhit, interesat e borxhit.
- **Humbjet dhe detyrimet e mundshme** provizionet për humbje dhe detyrime të mundshme në të ardhmen, humbjet nga këmbimi i valutës.

- **Shpenzimet e përfituesit** si: shpenzimet e deklaruara nga përfituesi dhe që mbulohen nga ndonjë veprim apo program tjetër, shpenzimet për lëndë të parë, pagat dhe mëditjet, shpenzimet operacionale (qira, rryma, uji, etj.).
- **Blerja e pajisjeve dhe makinerive të përdorura.**
- **Tatimet dhe tarifatat** si: tatimet mbi të ardhurat, tarifatat bankare, shpenzimet për garanci dhe tarifa të ngjashme.
- **Kreditë dhe detyrimet ndaj palëve të treta:** Kreditë ndaj palëve të treta.
- **Shpenzimet për ndërtim dhe riparim:** Blerja e tokës, ndërtimi apo riparimi i ndërtesave/objekteve (përfshirë depot dhe struktura të ngjashme).
- **Gjobat dhe shpenzimet gjyqësore:** Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet gjyqësore.
- **Amortizimi dhe ndarja e fitimeve:** Shpenzimet e amortizimit që zakonisht përfshihen në ndarjen e fitimeve.
- **Automjetet dhe transporti:** Automjetet dhe shpenzimet e transportit.
- **Inventari:** Inventari (tavolinat, karriget, dollapët), përjashtuar ato që lidhen drejtpërdrejt me aktivitetin si dhe aksesorët e makinave.

Shënim: Nëse kostot e papranueshme përbëjnë mbi 20% të projektit, aplikacioni refuzohet. Të gjitha kostot e papranueshme (nën 20%) duhet të mbulohen nga vet përfituesi dhe zbriten nga buxheti i përgjithshëm i projektit duke ruajtur përqindjen e pjesëmarrjes së grantit dhe bashkëfinancimit të propozuar në aplikacion.

Parandalimi i mashtrimit dhe penalizimet

Çdo tentativë mashtrimi (*falsifikim faturash, blerja e makinave apo pajisjeve të përdorura, etj.*) do të penalizohet me:

- Mos-pagesë të shumës përkatëse,
- Përjashtim të plotë nga mbështetja,
- Ndjekje sipas ligjit për konfiskim.

VLERAT E PLANIFIKUARA TË MBËSHTETJES FINANCIARE

Shuma e planifikuar për këtë thirrje është **842,969.64 euro**. Megjithatë, **Ministria e Zhvillimit Rajonal** rezervon të drejtën që të mos shpërndajë tërësisht këtë shumë, varësisht nga ecuria e procesit të vlerësimit dhe zbatimit.

Grupi i synuar	Shuma minimale	Shuma maksimale
LOT1	16,000.00€	30,000.00€

Bashkëfinancimi i aplikantit duhet të jetë minimumi 10% dhe maksimumi 49%, pra shuma që kërkohet nga Ministria e Zhvillimit Rajonal nuk mund të jetë nën 51% e kostos totale të projekt propozimit.

DOKUMENTET E KËRKUARA PËR APLIKIM

Lista e dokumenteve që duhet të dorëzohen

Aplikimi do të konsiderohet i plotë nëse përmban formën e aplikimit dhe anekset e detyrueshme, siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin përkatës, si më poshtë:

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit** me të gjitha fletët/informatat përcjellëse e lëshuar nga ARBK.
- Qarkullimi vjetor për vitin paraprak (2025) siç është deklaruar në ATK.**
- Vërtetimi tatimor** jo më i vjetër se 3 muaj nga dita e aplikimit dhe duhet të ketë përmbajtje që vërteton se aplikuesi nuk ka borxhe tatimore të pashlyera, ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK (*mund të nxirret online nga ueb faqja e ATK-së*).
- Lista e punëtorëve** e lëshuar nga ATK për vitin 2025 (*mund të nxirret online nga ueb faqja e ATK-së*), si dëshmi që biznesi kategorizohet në bizneset mikro apo të vogla.
- Foto të objektit ekzistues dhe të biznesit**, (fotove të objektit, hyrjes në të bashkë me logon/panon e biznesit, aparatura apo makineria dhe tregues tjerë eventuale).
- Oferta për makineritë/pajisjet** e planifikuara për projektin, që përfshin:
 - Vlerën totale të projektit.
 - Të dhëna të sakta për ofertuesin dhe marrësin e ofertës.
 - Emërtimin dhe specifikimin teknik të saktë për secilën njësi të makinerisë /aparaturës.
 - Oferta nuk duhet të jetë më e vjetër se data e publikimit të kësaj thirrje publike, si dhe duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga kompania që lëshon ofertën.
 - Ofertat preferohet të jenë në valutën EURO, megjithatë në rastet kur oferta është në ndonjë valutë tjetër aplikuesi duhet të bashkëngjisë edhe dëshminë e kalkulimit (kursin valutor) të datës së marrjes së ofertës.

SHËNIM: Dokumentet që dorëzohen nga aplikantët duhet të jenë të hartuara në alfabetin latin dhe të përmbajnë datim sipas kalendarit gregorian. Çdo dokument i paraqitur në këtë formë do të konsiderohet i vlefshëm dhe i pranueshëm për qëllime të procesit të aplikimit dhe vlerësimit.

NDIHMË DHE MBËSHTETJE

Kontakte për pyetje dhe ndihmë

Të gjitha pyetjet në lidhje me thirrjen mund të bëhen vetëm në mënyrë elektronike në email-in: dpkzhr@rks-gov.net deri më 05.06.2026 deri në ora 16:00.

Përgjigjet do të publikohen në faqen zyrtare të MZHR-së, sipas kalendarit indikativ 08.06.2026.

AFAFTET E APLIKIMIT

Data e hapjes dhe mbylljes së aplikimit

Afati për dorëzimin e aplikacioneve fillon më 18.05.2026 dhe përfundon më 18.06.2026, në orën 16:00.

Korrigjimi i lëshimeve teknike gjatë fazës së aplikimit

Aplikantët kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për të korrigjuar çdo lëshim teknik eventual që mund të ndodhi gjatë aplikimit online. Lëshimet teknike mund të përfshijnë një gamë të gjerë problemesh që ndodhin gjatë procesit të aplikimit. Këto mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, gabime të tilla si:

- **Gabime në formatin e dokumenteve të dorëzuara**
- **Ngarkimi i gabuar i dokumenteve**

Për t'iu mundësuar aplikantëve të korrigjojnë gabimet eventuale, ata kanë mundësinë të paraqesin kërkesë jo më vonë se më **16.06.2026 në ora 15:00**, në e-mail-in dpkzhr@rks-gov.net MZHR do të kërkoj nga ASHI rihapjen e sistemit vetëm për ata që parashtrojnë kërkesës deri më **16.06.2026 në ora 15:00**.

Çdo aplikacion i dorëzuar do të regjistrohet dhe identifikohet përmes një numri digjital protokollit, i cili do të përdoret gjithashtu me rastin e publikimit të rezultateve në UEB faqen e MZHR-së.

II. VLERËSIMI

PROCESI I VLERËSIMIT DHE SELEKTIMIT

Vlerësimi i aplikacioneve do të realizohet në përputhje me Udhëzuesin për aplikim, Udhëzuesin dhe formatin për vlerësim dhe Udhëzuesin për zbatim të projekteve përfituese, këta Udhëzues hartohen nga Departamentit për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal.

MZHR do të formojë një komision vlerësues, i cili do të jetë përgjegjës për shqyrtimin e aplikacioneve dhe verifikimin e plotësisht të kushteve formale të përcaktuara në thirrjen publike.

Sipas këtij Udhëzuesi, komisioni vlerësues do të trajtojë aplikimet bazuar në kriteret e miratuara. Komisioni vlerësues do të hartoj raporte periodike (Faza I: Raporti i vlerësimi administrativ, Faza II: Raporti i vlerësimi përmbajtjesor dhe Faza III: Raporti i verifikimit në teren).

Raportet e Komisionit Vlerësues, përmes Sekretarit të Përgjithshëm, miratohen nga Ministri i Ministrisë për Zhvillim Rajonal.

Metoda e vlerësimit

Aplikacionet e pranuar do të kalojnë përmes fazave të mëposhtme të vlerësimit:

Faza I - vlerësimi administrativ

Komisioni Vlerësues do të kontrollojë të gjitha aplikacionet e pranuar për të verifikuar nëse ato i plotësojnë kushtet formale të thirrjes publike (a është bashkëngjit dokumentacioni i kërkuar)

Pas kontrollit, komisioni do të përgatisë dy lista:

- **Lista e aplikantëve që plotësojnë kushtet administrative.**
- **Lista e aplikantëve që nuk i plotësojnë kushtet administrative.**

Faza II - vlerësimi përmbajtjesor

Aplikantët që kalojnë fazën administrative do të vlerësohen nga komisioni në përputhje me Udhëzuesin dhe formularët përkatës të vlerësimit.

Vlerësimi nga komisioni vlerësues bëhet ekskluzivisht për Projektin e propozuar.

Komisioni vlerësues përgatitë listën e përfituesve preliminar (Faza II: Vlerësimi përmbajtësor) e cila publikohet në ueb të MZHR-së.

Faza III – verifikimi në teren

Komisioni Vlerësues do të vizitojë bizneset e para-kualifikuara për të verifikuar vërtetësinë dhe përputhshmërinë me të dhënat e prezantuara në aplikacion.

Dokumentet shtesë

Para nënshkrimit të kontratës MZHR do të kërkojë dokumentacion shtesë nga aplikantët, i cili përfshin:

- **Klasifikimi i aplikantit në Regjistrin e Kredisë Kosovës (CRK – Credit Registry of Kosovo)** për llogaritë personale të pronarit, aksionarëve dhe personave të autorizuar si dhe të biznesit. Klasifikimet e pranueshme nga CRK duhet të jenë në kategorinë A dhe B, kurse për kategorinë C do të kërkoen sqarime shtesë.
- **Konfirmimi nga banka për llogarinë aktive të biznesit.**
- **Certifikata që personi juridik nuk është shpallur i falimentuar ose është iniciuar procedura e falimentimit.**

DPKZHR do të kontrollojë dokumentacionin shtesë. Nëse pas kontrollimit të dokumenteve shtesë rezulton se aplikantët nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara nga thirrja publike, atyre nuk do të iu ofrohet kontrata për nënshkrim.

Faza e ankesave

Pas publikimit të rezultateve, aplikantët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë kundër vendimit të Komisionit Vlerësues pranë Komisionit të Ankesave.

Të gjitha ankesat në lidhje me thirrjen publike duhet të dorëzohen **në kopje fizike në arkivin e MZHR-së**, nga aplikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, **në afat prej 15 ditëve** pas publikimit të rezultateve në ueb faqen e MZHR-së.

Komisioni i Ankesave do të shqyrtojë dhe do të njoftoj palën me vendimin 15 ditë pas mbylljes së afatit të ankesave.

Faza e nënshkrimit të kontratave

Pas miratimit të raportit, do të nënshkruhen kontratat midis MZHR-së dhe përfituesve, përveç në rast se paraqitet ndonjë ankesë e bazuar dhe e konfirmuar nga Komisioni i Ankesave ose nuk e kalojnë fazën e tretë (verifikuese në terren).

Kriteret e vlerësimit

Pjesa/ Elementet e notimit	Vlera e përgjithshme/Pikët maksimale
1. Kapaciteti financiar dhe operacional	30
2. Relevanca e veprimit	20
3. Efektshmëria dhe arritshmëria	15
4. Qëndrueshmëria e veprimit	20
5. Buxheti dhe efektshmëria në kosto	15
GJITHSEJ PIKË (MAKSIMUM)	100

INFORMACIONE MBI MËNYRËN E NJOFTIMIT TË APLIKANTËVE TË PËRZGJEDHUR

Pas përfundimit të vlerësimit, rezultatet paraprake do të publikohen në ueb faqen e MZHR-së.

Lista rezervë

Aplikimet me pikët më të larta do të përzgjidhen si përfitues deri në shpenzimin e plotë të buxhetit në dispozicion.

Pas shpenzimit të buxhetit, aplikantët që kanë arritur 50 pikë e më shumë, do të mbeten në listën e pritjes/rezervë. Aplikantët do të renditen sipas pikëve që kanë fituar, duke filluar nga ata me më shumë pikë deri tek ata me më pak pikë të fituara.

Lista rezervë mbetet e vlefshme për vitin fiskal 2026 dhe në rast se Qeveria e Republikës së Kosovës ndan mjete shtesë (me rishikim të buxhetit apo me ndonjë vendim të veçantë) për këtë program lista rezervë do të financohet deri në shpenzimin e mjeteve të ndara.

III. ZBATIMI I PROJEKTIT

ZBATIMI DHE MONITORIMI I PROJEKTTIT

Pasi të nënshkruhet kontrata, do të fillojë faza e implementimit të projektit, që do të zhvillohet brenda afatit dhe kushteve të përcaktuara në kontratë.

- **Afati i implementimit:** Projekti duhet të përfundojë brenda 6 muajve nga realizimi i pagesës së avancit nga MZHR, përveç nëse është përcaktuar ndryshe në kontratë.
- **Zbatimi i projektit jashtë rajonit zhvillimor në të cilin ka aplikuar mund të bëhet vetëm me miratim paraprak të kompetenteve të MZHR-së.**
- **Afati për monitorim të projektit:** Përfituesi duhet të informojë Zyrtarin Monitorues së paku dy javë para skadimit të afatit të Garancionit Bankar për progresin e projektit. Mos informimi me kohë mund të sjellë sanksione.
- **Kërkesa për ndryshime:** Për çdo ndryshim eventual duhet të paraqitet kërkesë me shkrim në arkivin e MZHR-së, dhe vetëm pas marrjes së miratimit nga kompetentët e MZHR-së vazhdohet me implementim të projektit.
- **Afati për ndryshim të ofertës:** Ndryshimi i ofertës mund të kërkohen vetëm brenda 6 muajve pas pagesës së avansit nga MZHR. Kërkesa duhet të shoqërohet me dëshmi bindëse për nevojën e ndryshimit dhe dëshmi bankare (të datës së kërkesës) që dëshmon se fondet për implementimin e projektit janë në dispozicion – duke përfshirë edhe fondet e bashkëfinancimit.
- **Kufizimet e ndryshimeve:** Ndryshimet eventuale në projekt apo ofertë duhet të jenë në përputhje me projektin original dhe nuk mund ta ndryshojnë përmbajtjen kryesore të projektit.
- **Pajisjet duhet të aktivizohen menjëherë pas monitorimit dhe marrjes së miratimit nga zyrtari Monitorues.** Me rastin e monitorimit të vitit të dytë përfundimtar nëse pajisjet nuk janë vu në funksion/nuk janë përdorur do të kërkohet kthimi i mjeteve në vlerën e përfiturar.